

URDHËR
Nr. 4, datë 7.1.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Paskuqan;
- Njesisë Administrative Dajt;
- Njesisë Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njesisë Administrative Farkë;
- Njesisë Administrative Bërshull;
- Njesisë Administrative Vaqar;
- Njesisë Administrative Kashar;
- Njesisë Administrative Kamzë;
- Njesisë Administrative Zall-Herr;
- Njesisë Administrative Zall-Bastar.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njesisë Administrative Paskuqan;
- Njesisë Administrative Dajt;
- Njesisë Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njesisë Administrative Farkë;
- Njesisë Administrative Bërshull;
- Njesisë Administrative Vaqar;
- Njesisë Administrative Kashar;
- Njesisë Administrative Kamzë;
- Njesisë Administrative Zall-Herr;
- Njesisë Administrative Zall-Bastar.

3. Lëjimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influcencës Aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njesisë Administrative Paskuqan;
- Njesisë Administrative Dajt;
- Njesisë Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njesisë Administrative Farkë;
- Njesisë Administrative Bërshull;
- Njesisë Administrative Vaqar;
- Njesisë Administrative Kashar;
- Njesisë Administrative Kamzë;
- Njesisë Administrative Zall-Herr;
- Njesisë Administrative Zall-Bastar.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:

- Njesisë Administrative Paskuqan;
- Njesisë Administrative Dajt;
- Njesisë Administrative të Qytetit Tiranë;
- Njesisë Administrative Farkë;
- Njesisë Administrative Bërshat;
- Njesisë Administrative Vaqar;
- Njesisë Administrative Kashar;
- Njesisë Administrative Kamzë;
- Njesisë Administrative Zall-Herr;
- Njesisë Administrative Zall-Bastar.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:

- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”;

- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, “Për miratimin e Planit të Kontigjencës për Sëmundjen e Influencës Aviare”;

- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare”;

- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e biosigurisë ndaj Gripit të Shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë’”.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj